



Republika e Kosovës

Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit

Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Politikat e privatësisë

Ky dokument përcakton politikat e privatësisë të institucionit tonë në lidhje me mbrojtjen dhe përpunimin e të dhënave personale, në përputhje me Ligjin Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe aktet nënligjore përkatëse. Politika synon të garantojë transparencë, ligjshmëri dhe mbrojtje maksimale të privatësisë së individëve.

1. Qëllimi i përpunimit të të dhënave personale

Të dhënat personale përpunohen vetëm për qëllime të caktuara, të qarta dhe legjitime, siç janë:

- Ofrimi i shërbimeve dhe kryerja e funksioneve ligjore të institucionit;
- Administrimi i marrëdhënieve me qytetarët, punonjësit, bashkëpunëtorët dhe palët e treta;
- Përmbushja e detyrimeve ligjore dhe kontraktuale;
- Sigurimi i transparencës dhe llogaridhënies;
- Mbrojtja e interesave jetike të individëve kur është e nevojshme.

2. Parimet e përpunimit të të dhënave personale

Përpunimi i të dhënave personale mbështetet në parime të përcaktuara edhe në nenin 4 të Ligjit Nr. 06/L-082:

- **Parimi i ligjshmërisë, drejtësisë dhe transparencës** – të dhënat personale përpunohen në mënyrë të paanshme, të ligjshme dhe transparente, pa e cenuar dinjitetin e subjekteve të të dhënave;
- **Parimi i kufizimit të qëllimit** – të dhënat personale grumbullohen vetëm për qëllime të caktuara, të qarta dhe legjitime dhe nuk mund të përpunohen më tutje në kundërshtim me këto qëllime. Përpunimi i mëtejshëm me qëllim të arkivimit për interes publik, qëllimit të hulumtimit shkencor ose historik, ose qëllimit statistikor, nuk konsiderohet që është në mospërputhje me qëllimin fillestar;

- **Parimi i minimizimit të të dhënave** – të dhënat personale duhet të jenë adekuate, relevante dhe nuk duhet t'i tejkalojnë qëllimet për të cilat ato janë grumbulluar ose përpunuar më tutje;
- **Parimi i saktësisë** – të dhënat personale duhet të jenë të sakta dhe të përditësuara. Duhet të merret çdo hap i arsyeshëm për të garantuar që të dhënat personale që janë të pasakta, duke pasur parasysh qëllimin e përpunimit, të fshihen dhe të korrigjohen pa vonesë;
- **Parimi i kufizimit të ruajtjes** – të dhënat personale mund të ruhen vetëm për atë kohë sa është e nevojshme për arritjen e qëllimit, për të cilin janë grumbulluar ose përpunuar më tutje. Me rastin e përmbushjes së qëllimit të përpunimit, të dhënat personale asgjësohen, fshihen, shkatërrohen, bllokohen ose bëhen anonime, përveç nëse është paraparë ndryshe me Ligjin përkatës për Arkivat Shtetërore ose me ndonjë ligj tjetër përkatës;
- **Parimi i paprekshmërisë dhe konfidencialitetit** – të dhënat personale përpunohen në atë mënyrë që garantojnë siguri të përshtatshme të tyre, duke përfshirë mbrojtjen ndaj përpunimit të paautorizuar ose të paligjshëm dhe ndaj humbjes, asgjësimit ose dëmtimit aksidental, duke përdorur masa të përshtatshme teknike dhe organizative;
- **Parimi i llogaridhënies** – kontrolluesi duhet të jetë përgjegjës dhe në gjendje të zbatojë përputhshmërinë e të gjitha parimeve të përcaktuara me këtë nen.

3. Baza ligjore për përpunimin e të dhënave personale

Përpunimi i të dhënave personale bëhet në përputhje me nenin 5 të Ligjit Nr. 06/L-082 dhe mund të bazohet në:

- Pëlqimin e subjektit të të dhënave;
- Nevojën për përmbushjen e një kontrate;
- Përmbushjen e një detyrimi ligjor;
- Mbrojtjen e interesave jetike të subjektit të të dhënave ose një personi tjetër;
- Kryerjen e një detyre me interes publik ose ushtrimin e autoritetit zyrtar;
- Interesat legjitime të kontrolluesit ose palës së tretë, duke respektuar të drejtat themelore të subjektit.

4. Kategoritë e të dhënave të përpunuara

Institucioni mund të përpunojë kategoritë e mëposhtme të të dhënave personale:

- Të dhëna identifikuese (emri, mbiemri, numri personal, data e lindjes);
- Të dhëna të kontaktit (adresa, numri i telefonit, email-i);
- Të dhëna të punësimit (pozita, departamenti, të dhëna të kontratës së punës);
- Të dhëna financiare (llogari bankare, pagesa);
- Të dhëna të ndjeshme kur kërkohen me ligj (shëndetësore, biometrike, origjinë etnike, etj.), duke respektuar nenin 8 të ligjit.

5. Afatet e ruajtjes së të dhënave personale

Të dhënat personale ruhen vetëm për periudhën e nevojshme për të arritur qëllimin për të cilin janë mbledhur, ose për aq kohë sa kërkohet me ligj. Pas përfundimit të afatit, të dhënat personale mund të asgjësohen, fshihen, shkatërrohen, bllokohen ose të bëhen anonime, përveç nëse është paraprë ndryshe me Ligjin përkatës për Arkivat Shtetërore ose me ndonjë ligj tjetër përkatës.

6. Informacioni që ofrohet subjekteve të të dhënave personale

Në momentin e mbledhjes së të dhënave personale, ne sigurojmë informimin e plotë për:

- Identitetin dhe kontaktin e kontrolluesit dhe, kur është e aplikueshme, të përfaqësuesit të tij;
- Kontaktin e zyrtarit të mbrojtjes së të dhënave;
- Qëllimin e përpunimit dhe bazën ligjore;
- Interesat legjitime (kur përpunimi bazohet në nenin 5, paragrafi 1, pika 1.6.;
- Marrësit ose kategoritë e marrësve të të dhënave;
- Transferimin ndërkombëtar (nëse ndodh), duke përfshirë informacion për ekzistencën ose mungesën e një vendimi të përshtatshmërisë nga Agjencia për Informim dhe Privatësi;
- Afatin e ruajtjes së të dhënave ose kriteret për përcaktimin e tij;
- Të drejtat e subjektit të të dhënave dhe mënyrën e ushtrimit të tyre;
- Të drejtën për të paraqitur ankesë pranë Agjencisë për Informim dhe Privatësi;
- Obligimin ligjor për dhënien e të dhënave (nëse ekziston) dhe pasojat e mosdhënies;
- Ekzistencën e vendimeve të automatizuara, përfshirë profilizimin.

7. Të drejtat e subjekteve të të dhënave personale

Subjektet e të dhënave kanë të drejtë:

- Të informohen për përpunimin e të dhënave të tyre;
- Të kenë qasje në të dhënat e tyre;
- Të kërkojnë korrigjimin ose plotësimin e të dhënave;
- Të kërkojnë fshirjen e të dhënave (“e drejta për t’u harruar”).
- Të kërkojnë kufizimin e përpunimit;
- Të kundërshtojnë përpunimin;
- Të kërkojnë transferimin e të dhënave;
- Të mos i nënshtrohen vendimeve të bazuara vetëm në përpunim automatik, përfshirë profilizimin.

8. Transferimi i të dhënave personale

Çdo transferim në vende të treta ose organizata ndërkombëtare bëhet vetëm nëse:

- Ka vendim të përshtatshmërisë nga Agjencia, ose
- Janë zbatuar masa mbrojtëse të përshtatshme sipas ligjit.
-

9. Masat e mbrojtjes së të dhënave personale

Institucioni zbaton masa teknike dhe organizative për të mbrojtur të dhënat personale nga qasja e paautorizuar, përdorimi i paligjshëm, humbja apo dëmtimi, duke përfshirë:

- Enkriptimin e të dhënave;
- Kontrollin e qasjes përmes autorizimeve dhe fjalëkalimeve;
- Kopje rezervë të rregullta;
- Auditime dhe monitorim periodik;
- Trajnimin e stafit mbi mbrojtjen e të dhënave;
- Procedura për reagim ndaj incidenteve të sigurisë;

Zyrtari për mbrojtjen e të dhënave personale

Kontakti: Adonita Karavidaj

E-mail: Adonita.Karavidaj@rks-gov.net

Tel: +383(0) 38 200 44-722

E drejta për Ankesë

Nëse mendoni se të drejtat tuaja janë shkelur, mund të paraqitni ankesë pranë:

Agjencia për Informim dhe Privatësi

Rr. Zejnel Salihu – Nr.22, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

E-mail: info.aip@rks-gov.net

tel: 0800 600 10